

**MBI BASHKËPUNIMIN ME ÇETAT PARTIZANE
MAQEDONASE E GREKE DHE MBI SIGURIMIN
E USHQIMEVE PËR USHTRINË
NACIONALÇLIRIMTARE**

*Letër drejtuar Komitetit Qarkor të Partisë Komuniste
të Shqipërisë për Korçën*

23 shkurt 1943

Të dashur shokë,

Po ju japim disa udhëzime dhe përgjigje pyetjeve që na keni bërë më parë.

Sa herë që flitet o shkruhet për çeta duhet të vepronhet kështu: «Çeta partizane e vullnetare X (emri i çetës, për shembull: «Themistokli Gërmenji») e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare e komanduar prej shokut X ose prej patriotit Y» etj.

Organizata duhet të shtrihet në fshatrat e Prespës për të bërë agjitacion dhe me u propozue shokëve partizanë maqedonas që të kalojnë matanë kufirit të vjetër, në qoftë se kanë kondita për me jetue, dhe, në qoftë se kanë ikur prej reaksionit të madh, atëherë komandanti i çetës, komisari politik e zëvendësi duhet

të bisedojnë e të bashkëpunojnë me komandantin, komisararin e zëvendësin tonë; komandant le të jetë ai yni dhe të kenë flamurin tonë. Kjo do të ishte më e mira, por në qoftë se ata mund të jetojnë edhe në atë anë të kufirit, le të dalin anej. Për këto bisedime duhet që zëvendëskomisari ynë të takohet me zëvendëskomisararin e tyre dhe t'i kallëzojë qëndrimin tonë. Po të vijë puna për ndonjë aksion, vendimi le të merret prej të dy shtabeve bashkë, kështu le të vepronhet deri në kufirin e vjetër. Më këtë anë të kufirit duhet flamuri ynë, kurse tamam në kufi e në katunde aty afër mund të bashkohen të dy flamurët.

Pasi tani paraqitet nevoja ushqimore për çetat tona, duhet që ato të vepronjnë në këtë mënyrë: kur hapen depot duhet që shokët tanë të mbledhin katundarët e me një konferencë t'i bëjnë ata që t'u lënë shokëve tanë një sasi misri ose gruri, sepse problemi i ushqimit do të jetë shumë i madh; mundësisht të përgatiten depot tona. Të gjitha paret e qarkorit mund të shpenzohen për sende që u nevojiten çetave, por çetat duhet të këshillohen që të hanë në katundarë.

Çetës së Devollit shkruajini se mund të takohet me çeta greke për të bërë së bashku konferenca e po qe nevoja prapë së bashku mund të shkojnë nëpër katunde fqj kufirit e t'i flasim popullit për me i shpjegue vëllazërimin e dy luftërave nacionalçlirimtare, të Greqisë e të Shqipërisë. Secila le të mbajë flamurin e vet.

Karabinierët e këmishëzinjtë duhet me i vra si qentë, oficerët me i mbajtë rob dhe me na lajmëruë sa më parë që t'ju dërgojmë emrin e ndonjë shoku me të cilin të shkëmbehen.

Emrat e çetave «Drapër e Çekan» ose shenja të tilla duhet të hiqen.

Fetah Butkës i propozoni t'i shtrohet komandës sonë. Derisa t'i shtrohet komandës sonë le të kërkojë lidhje me njerëzit e tij, por derisa s'është nënshtruar, këshillojeni t'i heqë shenjat partizane.

Letrat këtej e tutje i bëni konspirative.

Lajmet që po ju çojmë i shumëzoni dhe i dërgoni edhe në çetat.

Të fala

S e l a m i

*Botuar për herë të parë
në: Enver Hoxha. Vepra,
vëll. 1. Tiranë, 1968*

*Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë*